



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01.09.2024
Kaçanik

Raport

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 Administratë të Hapur në Komuna.

Publikimi në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe facebook

<https://kacanik.rks-gov.net/shpalljet/>

<https://www.facebook.com/KomunaKacanik>

-Me 26.08.2024, është publikuar njoftimi për mbajtjen e takimit publik për : Planin komunal për transportin publik të udhëtarëve 2024-2028, mbajtur me 26.08. 2024. Takimi u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 14:00.

, Njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të komunës, facebookun e komunës.

Rikujtimi i publikuar në facebookun e komunës:

<https://www.facebook.com/KomunaKacanik>

Përmes formës elektronike në e-mailat e zyrtarëve përgjegjës për pranimin e komenteve, nuk është pranuar asnjë koment nga ana e qytetarëve, komente nuk ka pasur as në formën elektronike.

Komentet:

Bekim Terziu

Plani ka 46 faqe dhe trajton funksionimin e transportit publik. Pjesa e parë ka të bëjë me aspektin ligjor, gjendjen ekzistuese, linjat e udhëtimit, kabinat e ndalesave të autobusëve dhe dimensionet e tyre të cilat najë trajtuar edhe në aspektin ligjorë edhe në aspektin e gjendjes ekzistuese. Gjithashtu është marrë për bazë edhe regjistrimi i fundit i popullsisë që ndikon në mënyrën e planifikimit të shtrirjes së transportit publik. Operatorët janë në dijeni se cilat janë kompetencat e komunës në raport me transportin publik. Ne si komunë jemi përgjegjës për rregullimin e transportit publik brenda territorit të komunës sonë dhe i bëjmë planet për transportin publik urban, që në komunën tonë nuk kemi transport urban por kemi transport urbano periferik, nga qyteti në fshatra. Pjesa që mendoj se duhet të diskutohet janë objektivat e planit për periudhën e ardhshme 2024-2028, se çka mendojmë ne si komunë, si e shohim transportin publik për periudhën e ardhshme, cilat janë vend stacionet e ndaljes së autobusëve, cilat zona duhet të mbulohen, cilat zona do të detyrohemi t'i subvencionojmë sepse transporti publik më tepër është biznes, sepse ne nuk kemi transport të subvencionuar nga komuna. Ndodh që një lokalitet aktualisht nuk ka transport, siç e kemi fshatin Kotlinë, kemi bërë shpalljen por nuk kemi operator të interesuar për arsye se nuk e mbulon shpenzimi i operimit në atë pjesë për shkak të numrit të udhëtarëve. Kështu që kjo mund të na ndodh edhe me lokalitete tjera prandaj ne duhet ta kemi të qartë se si duhet të veprojmë në këtë aspekt. Ne kemi paraparë 4 objektivat kryesore.

Mbulueshmërinë e territorit të komunës me transport të udhëtarëve, kjo nënkupton që secilit lokalitet përmes DSHPE t'i ofrohet shpallja për operim në atë zonë.

Mbulueshmëria nënkupton që edhe atëherë kur nuk ka të interesuar, ne të gjejmë formën e mbulimit. Shenjzimi dhe mirëmbajtja e vendndalimeve të autobusëve, do të jetë objektivi i dytë. Do të kemi fokus eliminimin e vendndalimeve ilegale sepse ka rrezikshmëri për pjesëmarrësit në trafik por edhe për udhëtarët. Objektivi i tretë do të jetë ndërtimi i kabinave në vendndalimet për udhëtarë, pra aty ku vlerësohet që zakonisht ka ndalje të autobusëve por nuk ka kabina për udhëtarë, ne me projekte të komunës do të ndërtojmë kabinat. Sa i përket eliminimit të vendndalimeve ilegale për autobus, do të fokusohemi në fushata vetëdijesuese edhe për udhëtarë se jo çdo kund mund të ndalet autobusi. Për secilin objektivi kemi dhënë edhe sqarime në aspektin strategjik. Në tabela është paraparë edhe aspekti financiarë. Kjo ishte sa për informim rreth plani, ky plan do të debatohet edhe në Kuvendin e komunës pastaj do të dërgohet

edhe në ministrinë linje për aprovim. Jemi munduar t'i përfshimë të gjitha sa i përket transportit. Hapim debatin rreth këtij plani.

Hasip Salihu, administrator i fshatit Bajnicë- Duke e ditur se zona e Bajnicës ,nxënës në Kaçanik nuk kemi, punëtor i kemi 2-3, A ka ndonjë mënyrë të ketë marrëveshje ndërkomunale me ardh operatori i komunës së Ferizajt me krye këtë shërbim? A keni ju si drejtori , kur të ipet leja e transportit, caktohen kushtet e transportit? Orari i udhëtimeve nuk mbahet, sidomos gjatë pushimeve verore të fëmijëve.

Azem Koraçi, administrator i fshatit Kovaçec- Fshati Kovaçec nuk ka transport qe dy vite, nëse ka mundësi të subvencionohet. Kemi të interesuar të mbajnë vijën, por si duhet të veprohet?

Zjadin Zenuni, operator i transportit- Deshta t'i përgjigjem Hasipit, në pyetjen në lidhje me transportin në vijat që unë i mbajë. Problemi është me kompaninë "Endriti", problem me itineraret. Unë kam edhe terrenin në fshatin Semajë që është terren i vështirë. Jam detyruar me reduktuar rendin. Kam qenë edhe në zyrën tuaj që të gjejmë një zgjidhje për qytetarët lidhur me këtë vijë. Kam bërë edhe ankesë për kompaninë "Endriti". Të gjithë e dinë që kam edhe autobus edhe minibus, por vazhdimisht vjen duke u zvogëluar numri i udhëtarëve. Unë kam sugjeruar qytetarët të më thërrasin edhe në telefon ose në rrjete sociale.

Hasip Salihu, administrator i fshatit Bajnicë- Nuk kam asgjë personale me Zjadinin. Jam i ndikuar nga qytetarët dhe nga kompanitë, si administrator i fshatit. Nuk e di si mund të operohet me telefon. Unë jam për me i ndihmuar qytetarët.

Xhelal Selimi , operator i transportit- qytetarët e Bajnicës kanë ardhur në komunë e kanë kërkuar që kompania "Endriti" me operuar në Bajnicë. Mund të mos ndalesh me ankesa por është problem me ndal.

Rexhep Salihu, operator i transportit- Edhe unë e kam konkurrent kompaninë "Endriti", në fshatin Begracë, por nuk është fajtor kompania, sepse ka leje prej ministrisë. Fajtor është komuna. Çka ndodh nëse fillon viti i ri shkollor, i kam vetëm 1-2 nxënës në Begracë. Nuk ka qenë në gjendje komuna të hap drejtime në shkolla, për muzikë apo bujqësi.

Ramadush Osmani, drejtor në DSHPE- Për këtë arsye kemi menduar subvencionimin e operatorëve, ato të cilët janë të domosdoshme. Nëse hapim drejtime tjera në shkolla normal që vijnë nxënësit, por edhe drejtorja e arsimit i ka arsyet e veta.

Fadil Vishi, administrator i fshatit Dubravë- Sa i përket operatorëve në Dubravë jemi të kënaqur. Kam kërkesë mos të ndalet vija e orës 8. Më vjen mirë prej drejtorit që do t'i

subvencionon operatorët. Çështja e ndalesave të autobusit janë të shpeshta, është ngarkesë. Është ide e mirë e drejtorisë të caktohen vendndaljet.

Ziber Luma, administrator i fshatit Gllloboçicë- A do të startoj operimi në Gllloboçicë në muajin shtator?

Naser Murseli, administrator i fshatit Doganaj- Prej “Fushës së Pajtimit” deri në Doganaj autobusi ndalet 10 herë, që do të thot se është mirë që do t’i ndaloni vendndalimet ilegale për autobus. Duhet të kemi kujdes se cilës kompani i ipet tenderi. **Zjadin Zenuni**, operator i transportit- Sa i përket vijës Gllloboçicë- Shtrazë- Ivajë-Gajre-Kaçanik, a i keni paraparë kapacitetet dhe infrastrukturën e rrugës? Keni thënë se janë mbuluar të gjitha vijat, sa i përketë kësaj vije a është miratuar vendimi për operatorin?

Kemal Jaha, administrator i fshatit Stagovë- Ne me operatorin në Stagovë jemi të kënaqur, është i rregullt në të gjitha vijat.

Përgjigje

Sa i përketë fshatit Kovaçec, dy herë kemi hapur shpalljen , por nuk ka pasur të interesuar për këtë relacion. Kur e analizon komuna aspektin e subvencionimit të një vije, nënkupton që nuk kanë alternativë fare, si psh. Kotlina nuk ka asnjë alternativë. Kovaqeci ka alternativ rrugën Bob - Doganaj. Ka ekzistuar por operatori e ka ndal se nuk i ka arrit t’i mboloj shpenzimet operative.

Drejtorja miraton rendet dhe menaxhon transportin, relacionet ndër komunale i miraton ministria. Në ligjin për transport i mundësohet dy komunave fqinje të arrijnë marrëveshje ndër komunale. Ne duhet të lehtësojmë udhëtimin. Kjo duhet të trajtohet mes dy komunave duke mbrojtur operatorin që operon në zonën tonë. Tek rendet, njëherë në vit bëhet shpallja, vlerëson komisioni në bazë të dokumenteve, pastaj monitorimin në teren e bënë inspektorati. Sa i përket rendeve të udhëtimit, operatori është i obliguar të njoftoj drejtorinë për reduktimin e rendeve. Nëse pa paralajmërim tri herë nuk e mban rendin, atëherë ne hapim shpallje për atë vijë.

Vija e rregullt vazhdon me kompaninë “El travel”, ndërsa për nxënësit Drejtorja e Arsimit shpallë tender.

Drejtoria i miraton të gjitha rendet e udhëtimit, pastaj çka del jasht rregullores monitorimin e bënë inspektorati dhe policia e Kosovës.

Me autobus askush nuk mund të operojë në këtë pjesë , për shkak të terrenit .

Nëse nuk keni diçka tjetër për diskutim e shpalli të mbyllur debatin. Debati përfundoi në ora 15:25.

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik,

Lista e nënshkrimeve të zyrtarëve komunal si dhe qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik.

Raporti është përgatitur nga:

Fatlume Guri Selimi

Zyrtare e Lartë për Komunikim

